



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALIQ

Nr. 3847 Prot

Maliq me , 24.07.2017

KONTRATE

E lidhur sot ne daten 24.07.2017 midis Bashkise Maliq perfaqesuar nga Titullari Z.Gezim Topciu dhe Operatorit Ekonomik "Dricons" shpk me Nipt L52013020H , perfaqesuar nga Z. Ndreç Voci me karte identiteti nr.personal F61001059K me Liçense MK.1676/6 "Per mbikqyrje dhe kolaudim te punimeve te zbatimit zbatimi", i quajtur me poshte **KONTRAKTUESI**

BAZA LIGJORE

Ligji Nr.9643, date.20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar , Ligji Nr.8402 date.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" Kreu III "Projektimi , mbikqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve te ndertimit" Neni 7, i ndryshuar, V.K.M. Nr.68, date 15.02.2001 , pika 2 "Per miratimin e kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te punimeve te ndertimit", Udhezimi i K.M. Nr.1 date 16.06.2011 "Per disa shtesa te Udhezimit Nr.3 date.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit".

KUSHTET E KONTRATES

Neni 1
OBJEKTI I KONTRATES

Mbikqyrja e punimeve ne objektin:

"Rivitalizim i fshatit Sovjan dhe Luadishte permiresimit te infrastructures rrugore"

Neni 2
KOHEZGJATJA E KONTRATES

1. Afati kohor per ekzekutimin e kontrates eshte 5 (pese) muaj nga data e nisjes se punimeve ne objekt.
2. Kontraktuesi duhet te paraqitet ne kantier çdo dite nga data e fillimit te punimeve dhe deri ne perfundim pa shkeputje. Paraqitja e mbikqyresit ne kantier do nte kontrollohet nga perfaqesuesi i investitorit (Bashkia Maliq) Z. Spiro Koti dhe Operatori ekonomik "Dricons" shpk .
3. Ne rastin kur mbikqyresi nuk paraqitet per 2 (dy) dite pa arsye dhe ma njoftuar me pare Autoritetin kontraktor kontrata zgjidhet menjehere.

Neni 3
VLERA E KONTRATES

Vlera e kontrates sipas Ofertes te paraqitur ne tender eshte :
31.200 (tridhjetenjemije e dyqinde)
37.440 (tridhjeteshatemije e katerqindedyzetekater)

leke pa Tvsh
leke me Tvsh



**Neni 4
AFATET E PAGESES**

1. Paga do të kryhet nga Autoriteti Kontraktor pas perfundimit të punimeve.
2. Paga do të kryhet në leke Shqiptare në llogarinë bankare të Kontraktuesit.

**Neni 5
DETYRIMET E KONTRAKTUESIT**

**Neni 5/1
GJATE NGRITJES SE KANTJERIT**

1. Të bëjë Akt dorzimit të sheshit të ndërtimit.
2. Të bëjë Raport për gjendjen faktike të sheshit, përputhjen e projektit me faktin dhe ndryshimet e nevojshme për realizimin e projektit.

**Neni 5/2
GJATE ZHVILLIMIT TE PUNIMEVE**

1. Të bëjë kontrollin e materialeve që do të përdoren në kantier sipas kërkesave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
2. Raport javor për ecurinë e zbatimit të punimeve në përputhje me grafikun e zhvillimit të punimeve.
3. Informacion për kontrollin e ushtruar në objekt.
4. Kontrolli i punimeve sipas KTZ dhe punimet maskuara, me proces –verbalin përkatës.
5. Kontrollin e ditari të objektit.

**Neni 5/3
NE PERFUNDIM TE PUNIMEVE**

1. Konfirmim të perfundimit të punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes.
2. Sigurim nga sipërmarrësi të deklaratës teknike.
3. Hartim të relacionit të perfundimtar për mbikqyrjen e punimeve.

Mbikqyresit i punimeve duhet të përgatisë dosjen për kolaudimin e punimeve jo më vonë se 10 ditë nga data e perfundimit të punimeve. Bashkëngjitur me relacionin të perfundimtar të punimeve duhet të shoqërohet me këto dokumente:

- Projekti i plote i zbatimit.
- Ndryshimet dhe shtesat në projekt.
- Preventivi i punimeve.
- Situacionet pjesore dhe perfundimtar të pranuar prej tij.
- Procesverbalet e punimeve të maskuara.
 - Për nënshtresat.
 - Për rrjetin e infrastrukurës.
- Procesverbalet e provave të sistemeve të infrastrukurës.
 - Pa ngarkesë.
 - Me ngarkesë.
- Certifikatat e cilësive të materialeve kryesore dhe produkteve të gatshme.
- Libreza e masave.
- Ditari i objektit.
- Deklaratë teknike të sipërmarrësit.



Neni 6
PUNIMET NDERPRITEN NE RAST SE:

Autoriteti Kontraktor, Kontraktuesi ose Mbikqyresi i Punimeve bejne shkelje themeloret te kontrates, ose Autoriteti kontraktor ka arsye objektive

Atehere Autoriteti Kontraktor bashkepunin me Mbikqyresin dhe Kontraktuesin duke perpiluar procesverbalet e gjendjes se punimeve ne castin e nderprerjes se punimeve shoqeruar me te gjitha dokumentacionin e disponueshem.

Neni 7

Mosmarveshjet midis paleve zgjidhen ne rrugen e mirkuptimit ,ne rast te kundert zgjidhen ne Gjykaten Administrative te Shkalles se Pare Korçe, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Kontrata u hartua ne 4 (kater) kopje nga te cilat 3 (tre) i merr Autoriteti Kontraktor dhe 1 (nje) Kontraktuesi.

KONTRAKTUESI
Operatori "Dricons"



AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA MALIQ

Perfaqesuar nga
Kryetari i Bashkise
Z. Gezim TOPÇIU

